




Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



Prishtinë, 12.06.2025
Kodi i ZRRE-së: V_2727_2025

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Duke marrë parasysh:

- Dispozitat e Nenit 9 paragrafi 1, nënparagrafi 1.7, Nenit 15 paragrafi 5 dhe 6, Nenit 26, paragrafi 1, nënparagrafin 1.2, , të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084);
- Dispozitat e Nenit 18 të Licencës për prodhim të Energjisë Elektrike të Air Energy SH.P.K, Numri i licencës ZRRE/Li_62/19 dhe
- Kërkesën me shkrim të datës 04 shkurt 2025 për ndryshim kontrolli – të bërë nga përfaqësues të Air Energy SH.P.K, me adresë Rr. Isa Boletini, p.n.54/3, 60000, Gjilan, Republika e Kosovës.

në seancën e mbajtur me datë 12.06.2025 nxori këtë:

VENDIM

- I. APROVOHET ndryshimi në kontroll (kapitali aksionar) i Air Energy SH.P.K,** (Numri i Biznesit: 70490935, Numri Unik Identifikues 811181156), Numri i licencës ZRRE/Li_62/19, aktiviteti i Prodhimit të Energjisë Elektrike.
- II. Obligohet aksionari tek te i cili kalojnë 100% e aksioneve të Air Energy Sh.P.K. të veproj sipas dispozitave të licencës së sipërpërmendur dhe legjislacionit tjetër në fuqi, nga data e aprovimit të ndryshimit në kontroll. I njëjti duhet të sjell në Rregullator çdo dokument të lëshuar nga institucione të ndryshme për këtë subjekt, të cilët mund të kenë ndikim në validitetin dhe periodhën e vlefshmërisë së licencës, si dhe çdo dokument i cili mund të ndryshoj nga ai i sjellë gjatë aplikimit për marrje të licencës.**

Arsyetim

- Zyra e Rregullatorit për Energji me datë 04 shkurt 2025 përmes përfaqësuesit me prokurë të subjektit juridik Air Energy SH.P.K., ka pranuar kërkesën me titull “NJOFTIM PËR PLANIFIKIM TË NDRYSHIMIT TË STRUKTURËS SË BRENDSHME TË PRONËSISË”, ku kërkohet nga ZRRE aprovimi i ndryshimit në kontroll.
- Zyra e Rregullatorit për Energji me datë 15 nëntor 2018 i ka lëshuar Air Energy-së Licencë të përkohshme (në mungesë të Lejes Mjedisore), duke filluar nga data 11.10.2018 kur gjeneratori ka hyrë në operim komercial e deri 10.10.2019. Më pastaj me datë 28.02.2019 Air Energy SH.P.K është licencuar për periudhë nga data 11.10.2018 (kur gjeneratori ka hyrë në operim komercial) deri me datë 10.10.2058 (pra për 40 vite).
-



- Sipas Nenit 18 të licencës kërkohet, citoj: *“I licencuari do të njoftojë Rregullatorin për ndonjë ndryshim që pritët të kontroll së paku gjashtëdhjetë (60) ditë, paraprakisht. Ndryshimi në kontroll nuk do të jetë efektiv derisa Rregullatori nuk e aprovon”.*
- Gjithashtu sipas Nenit 15 paragrafi 5 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, parashihet, citoj: *“Ndërmarrjet e energjisë të licencuara nga Rregullatori duhet të aplikojnë tek Autoriteti Kosovar i Konkurrencës në përputhje me Ligjin për Konkurrencën, lidhur me vendimet për bashkim të ndërmarrjeve ose çfarëdo ndryshimi tjetër të kontrollit mbi ndërmarrjen e licencuar. Në këto raste, Autoriteti Kosovar i Konkurrencës merr parasysh mendimin e Rregullatorit.”*
- Bazuar në këtë me datë 03 shkurt 2025 pala i është drejtuar Autoritetin e Konkurrencës, sipas Nenit 15 paragrafi 5 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë dhe dispozitat përkatëse të Ligjit nr. 08/L-056 për mbrojtjen e konkurrencës, duke sqaruar se: Air Energy Sh.P.K me NUI 811181156, me nr licence ZRRE/Li_62/19, të datës 28 shkurt 2019, për prodhimin e energjisë elektrike përmes burimeve te ripërtëritshme, me kapacitet prej 32.4 MW **aktualisht zotërohet nga:**
 - Shoqëria turke **“Guris Insaat ve Ticaret Muhendislik”**, shoqëri me përgjegjësi të kufizuara, e themeluar në pajtim me ligjet e Turqisë, e me numër të regjistrimit 27130 (“Guris”). Kjo shoqëri (në këtë rast “Shitësi”), zotëron 100% të kapitalit aksionar të Air Energy. Pronar fundor të kësaj shoqërie janë **Tefvik Yamanturk (50%)** dhe **Musfik Hamdi Yamanturk (50%)**. Kjo shoqëri do të shet 100% të kapitalit aksionar që zotëron në Air Energy tek,
 - Shoqëria holandeze **Mogan Europe B.V**, që është pjesë e të njëjtit grup. Mogan Europe B.V (“Blerësi”), zotërohet poashtu nga **Tefvik Yamanturk (50%)** dhe **Musfik Hamdi Yamanturk (50%)**, ku të njëjtit janë edhe pronar fundorë edhe të “Guris Insaat ve Ticaret Muhendislik”.

Me datë 13 shkurt 2025 Autoriteti Kosovar i Konkurrencës është përgjigjur për këtë çështje, citoj *“Ndërmarrja Air Energy, e cila zotërohet nga shoqëria turke Guris Insaat ve Ticaret Muhendislik”, shoqëri me përgjegjësi të kufizuara, e themeluar në pajtim me ligjet e Turqisë, e me numër të regjistrimit 27130 (“Guris”). Kjo shoqëri zotëron 100% të kapitalit aksionar të Air Energy. Guris, do të shes 100% të kapitalit aksionar që zotëron në Air Energy tek shoqëria holandeze Mogan Europe B.V, që është pjesë e të njëjtit grup. Mogan Europe B.V (“Blerësi”) zotërohet nga Tefvik Yamanturk (50%) dhe Musfik Hamdi Yamanturk (50%), të cilët janë pronar fundorë edhe të Guris (“Shitësit”). Autoriteti i Konkurrencës së Republikës së Kosovës, ka vlerësuar dokumentacionin e paraqitur përmes e-mailit, datës 03.02.2025, gjithashtu struktura e paraqitur në formë të diagramit, nga ndërmarrjet/palët, në transaksion, përkatësisht të Guris dhe Mogan (palët e ndërlidhura). Nga sa më lartë, bazuar në nenin 11 paragrafi 4, nënparagrafi 2, Ligjit 08/L-056 për Mbrojtjen e Konkurrencës, transaksioni nuk konsiderohet si Përqendrim për qëllime, të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, citojmë dispozitën “blerja e aksioneve për shkak të ristrukturimit të brendshëm të ndërmarrjes dhe lidhur me fitimin e kontrollit të përbashkët, bashkimin ose bartjen e pronësisë” dhe si i tillë nuk i nënshtrohet detyrimit për të kërkuar lejin e përqendrimit, sipas nenit 11 dhe 13 të Ligjit 08/L-056 për Mbrojtjen e Konkurrencës.*

- Me datë 5 mars 2025 Air Energy Sh.P.K është udhëzuar nga ZRRE që të bëjë ndryshimet e nevojshme në ARBK dhe dokumentet e tilla të ndryshuara të sillen në ZRRE.



- Me datë 18 prill 2025 Air Energy ka dorëzuar në ZRRE edhe Statutin e ndryshuar të këtij subjekti, në përputhje me Ligjin për Shoqëritë Tregtare, ku shihet se pronar i këtij subjekti tanimë është **Mogan Europe B.V.** me adresë në Holandë. Air energy ka vepruar edhe në pajtim me pikën V të dispozitivit të Vendimit V_1117_2019 dt. 28.02.2019, me të cilin kërkohet që të dorëzojë në ZRRE çdo document i lëshuara nga institucione të ndryshme të cilat janë të ndryshme nga ato të sjella gjatë aplikimit për marrje të licencës.
- Me 18 prill 2025 Air Energy SH.P.K poashtu ka dorëzuar Resolution (Vendim/Resolute) sipas të cilit me datë 14.03.2025 ishte aprovuar Marrëveshja për Shitje të 100 % të aksioneve të shoqërisë në mes **GURIS MUHENDISLIK ANONIM SIRKETI** dhe **Morgan Europe B.V.**, si më sipër.
- Rregullatori pas vlerësimit të kërkesës së Air Energy SH.P.K dhe dëshmive/komunikimeve tjera të sipërpërmendura dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

III. Vendimi nxirret në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.

IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i Rregullatorit dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të Rregullatorit.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimi të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të Rregullatorit, cilado që ndodh e fundit.

Vendimi i dërgohet:

- Ndërmarrjes **Air Energy SH.P.K** (prodhim i energjisë elektrike) dhe
- Arkivit të Zyrës së Rregullatorit për Energji

Bordi i Rregullatorit:

Ymer Fejzullahu, Kryesues

Lutfije Dervishi, anëtare

Gani Buçaj, anëtar

Artan Isufi, anëtare

Adnan Preniqi, anëtar